

Data	05.11.2024	Vendi	Kaçanik
Nj. org.		Numri	
		Shënimi	
01-370/01-28121/24			



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

ANEKS-KONTRATË PËR PUNË

I KONTRATËS BAZË MBI KRYERJEN E PUNËVE me 01.NR.370/01-18282 të datës 02.08.2024

E përpiluar më 05.11.2024 në mes të Komunës së Kaçanikut- Zyrës së Prokurimit ,të cilën e përfaqëson z. **Izahir Kuka** , u.d. Menaxher i Zyrës së Prokurimit dhe “**MALI ART GROUP**” Shpk nga Kaçaniku te cilën e përfaqëson **Muhamet Berisha** në cilësinë e kryesit të Punëve.

I

Duke pasur parasysh se palët kanë lidhur kontratë “**Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjellsëve në lokalitetet Ivajë – Kaçanik** lidhur më dt. **02.08.2024**. Duke u bazuar në punimet korrekte nga kontrktuesi, nevojës për punë shtesë lidhur me kompletimin e Projektit, kërkeses nga Menagjeri i Projektit dhe Kryesi i punëve për punë shtesë për kompletimin e Projektit, si dhe bazuar në Aprovimin e kërkeses nga ZKA dhe Raportit të komisionit të formuar nga ZKA si dhe bazuar në LPP neni 35 të lidhim **Aneks Kontratë për Projektin “Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjellsëve në lokalitetet Ivajë – Kaçanik**, puna shtesë.

II

Komuna e Kaçanikut- për punët e kryera sipas pikës i të kësaj Aneks kontrate,obligohet që pagesat të bëhen dhe atë në vlerë prej **1,500.00€** dhe me fjalë (**Njëmijëepesëqindëeuro**), duke përfshirë të gjitha taskat dhe tatimet e aplikushme bazuar në ligjet në fuqi. Të gjitha obligimet tjera kontraktuale lidhur me këtë Projekt respektivisht kushtet e Kontratës dhe KVK mbesin kushtet e Kontratës bazë.

IV.

Aneks Kontrates i bashkangjitet Kërkesa për punë shtesë, Aprovimi nga Komisioni i autorizuar nga ZKA, Njoftimi KRPP deh publikimi i Njoftimit për udhëheqjen e Procedures se negocuar dhe zotimi i mjeteve për kete destinim.

Vlefshmëria e Aneks Kontratës fillon prej dt.06.11.2024 dhe dinamika e kryerjes se punimeve është 10 ditë kalendarike.

IV

Bazë për nxjerrjen e kësaj Aneks Kontrate është kërkesa e të dyja palëve për vazhdimin e kontratës dhe Aprovimit nga ZKA-se, njoftimi i KRPP-se me form standard dhe publikimi i njoftimit

V

Dispozitat të kontratës bazë mbesin të pa ndryshuara..

VI

Kjo Aneks Kontratë hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

KONTRAKTUESIT:

Kaçanik: 05.11.2024

PËR :

**“MALI ART GROUP “ Shpk
Muhamet Berisha**



**Për : KK.-Kaçanik
U.d. Menagjerit të Prokurimit
Izahir Kuka**



PARAMASA ME PARALLOGARI E PUNEVE SHITES

E PUNIMEVE PER NDERTIMIN E KAPTAZHES, ODES AKUMULUESE DHE RRJETIT FURNIZUES TE UJESJELLESIT NE SEGMENTIN : IVAJE - RRJETI KRYESOR I QYTETIT - KAÇANIK

A3/ VAZHDIMI I RRJETIT PRIMAR FURNIZUES I UJESJELLESIT DERI TE REZERVUARI I RI I IVAJES

1	Gërmimi i dheut të kat. së IV-të dhe V-të me makineri - marimangë për hapjen e trashës së kanalit të rrjetit të ujësjellësit. Dheu i gërmuar të lihet anash për përdorim të pjesërishëm të tij. Dimensionet e gërmimit të kanalit janë: Thellësia h _{min} =0.8 m, gjerësi b= 0.7m dhe gjatësi L=600m. Llogaria të bëhet për m ³ të dheut të gërmuar.	110.00	m ³	3.00	eu/m ³	330.00
2	Mbulimi i kanalit me dheun e gërmuar - i përzgjedhur (i pjesërishëm) pas montimit dhe testimit të gypave. Mbulimi i kanalit të bëhet me shtresa duke bërë ngjeshjen dhe materiali i përdorur duhet ti plotësoj kushtet teknike. Llogaria të bëhet për m ³ të materialit të përdorur.	110.00	m ³	0.80	eu/m ³	88.00
3	Sigurimi, transporti dhe montimi i gypit, me diametër Ø75 mm, PE100 RC, SDR11, PN10 bar me elektrosaldim. Në llogari hyne kyqja në rrjetin kryesor të sistemit të rrjetit të qytetit. Llogaria bëhet për m' të gypit të montuar.	327.88	m'	3.30	eu/m'	1082.00
Sh. Totale A3:						1500.00

REKAPITULIM I PËRGJITHSHËM

A3/ VAZHDIMI I RRJETIT PRIMAR FURNIZUES I UJESJELLESIT DERI TE REZERVUARI I RI I IVAJES	1500.00
SHUMA TOTALE	1500.00

Mali Art Group SH.P.K.

Kaçanik, 16.10.2024



[Handwritten signature]